

I. Llojet e Taksave vendore

1. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme në të cilën përfshihen
 - Taksa mbi ndërtesat
 - Taksa mbi tokën bujqësore
 - Taksa mbi truallin
2. Taksa e fjetjes në Hotel
3. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja
4. Taksa e Tabelës
5. Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

II. Llojet e Taksave të ndara

1. Të ardhura nga regjistrimi i mjeteve të përdorura.
2. Të ardhura nga renta minerare.
3. Të ardhura nga TAP.
4. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

III. Llojet e tarifave

1. Tarifa e Pastrimit për Familjet
 2. Tarifa për Shërbimin Komunitar
 3. Tarifa e Pastrimit për Biznesin
 4. Tarifa e Gjelbërimit për Biznesin
 5. Tarifa e Ndriçimit për Biznesin
 6. Tarifa për mjetet e transportit
 7. Tarifa për dhënie Leje ushtrim aktiviteti
 8. Tarifa për Shërbime Administrative dhe urbanistike
 9. Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike
 10. Tarifa e Ndotjes Mjedisore/Përmirësim Mjedis
 11. Tarifa të ndryshme në funksion të Drejtorive dhe Ndërmarrjeve vartëse.
- Tarifa për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Patos.

2.2 Niveli i taksave

a) Taksa e ndërtesës

Mënyra e llogaritjes së taksës për m² sipas kategorive

| Nr. | Kategoritë dhe nënkategoritë | Njësia | Niveli i taksës mbi ndërtesat | |
|-----|------------------------------|--------|-------------------------------|------------------------|
| | | | Bashkia Patos | Njësitë Administrative |
| | | | | |

| | | | | |
|-----|---|--|---|---|
| | Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për banim para vitit 1993 | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 70\% \times 0.055$ $\times m^2 = 10.78 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 70\% \times 0.05$ $\times m^2 = 9.80 \text{ lekë}/m^2$ |
| 1 | Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për banim pas vitit 1993 | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 0.055 \times m^2 =$ $15.40 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 0.05 \times m^2 =$ $14 \text{ lekë}/m^2$ |
| 2 | Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për veprimtari ekonomike (tregëti dhe shërbime) | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 1.5 \times m^2 \times$ $0.26\% = 109.2 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 1.5 \times m^2 \times$ $0.22\% = 92.4 \text{ lekë}/m^2$ |
| 3 | Veprimtari industriale, prodhimi, përpunimi, magazinimi i mallrave industriale duke përfshirë depo t, magazinat dhe objekte të ngjashme | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28000 \times 0.26\% \times m^2 \times$ $50\% = 36.4 \text{ lekë}/m^2$ | $28000 \times 0.22\% \times m^2 \times$ $50\% = 30.80 \text{ lekë}/m^2$ |
| 3.1 | Ndërtesat për veprimtari arsimore jo publike të çdo niveli si dhe ambientet sportive të mbyllura përfshi dhe pishinat e mbyllura | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28000 \times 0.26\% \times m^2 \times$ $50\% = 36.4 \text{ lekë}/m^2$ | $28000 \times 0.22\% \times m^2 \times$ $50\% = 30.80 \text{ lekë}/m^2$ |
| 4 | Parkim i mbuluar dhe bodrume Ndërtim konstruksioni druri dhe metalik | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 0.26\% \times m^2$ $\times 70\% = 50.96 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 0.22\% \times m^2$ $\times 70\% = 43.12 \text{ lekë}/m^2$ |
| 5 | Parkim i hapur | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 0.26\% \times m^2$ $\times 30\% = 21.84 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 0.22\% \times m^2$ $\times 30\% = 18.48 \text{ lekë}/m^2$ |
| 6 | Veprimtari në fushën e bujqësisë dhe blektorisë si dhe veprimtari mbështetëse si grumbullim, magazinim dhe ruajtje produkte bujqësore e blektorale me përjashtim të përpunimit ushqimor | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 0.26\% \times m^2 \times$ $30\% = 21.84 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 0.22\% \times m^2$ $\times 30\% = 18.48 \text{ lekë}/m^2$ |
| 7 | Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje | Lekë/ m ² / sip shfrytëzimi | $28,000 \times 0.26\% \times m^2 \times$ $30\% = 21.84 \text{ lekë}/m^2$ | $28,000 \times 0.22\% \times m^2$ $\times 30\% = 18.48 \text{ lekë}/m^2$ |

| | | | |
|--|--|--|--|
| ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. | | | |
|--|--|--|--|

b) Taksa e tokës bujqësore

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

| Nr. | Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore | Vlera sipas Ligjit lekë/hektar/vit |
|-----|---|------------------------------------|
| 1 | I | 5600 lekë/ha/vit |
| 2 | II | 4900 lekë/ha/vit |
| 3 | III | 4200 lekë/ha/vit |
| 4 | IV | 3600 lekë/ha/vit |
| 5 | V | 3000 lekë/ha/vit |
| 6 | VI | 2400 lekë/ha/vit |
| 7 | VII deri X | 1800 lekë/ha/vit |

c) Taksa e truallit

Niveli i taksës mbi truallin

| Bashkia Patos | Vlera e taksës për qëllime banimi për individë | Vlera e taksës për qëllime biznesi |
|---------------|--|------------------------------------|
| | 0.14 lekë/m ² /vit | 15 lekë/ m ² /vit |

d) Tarifa e pastrimit për individ

| Kategoritë | Niveli i tarifës së Pastrimit për Familjet. |
|--|---|
| <p>Njësia Administrative Patos:</p> <p>1 Familje e përbërë me 1 deri 2 persona sipas çertifikatës familjare.</p> <p>2 Familje e përbërë me 3 dhe më shumë persona sipas çertifikatës familjare.</p> | <p>2,900 lekë/vitë</p> <p>4,100 lekë/vitë</p> |
| <p>Njësia Administrative Zharëz:</p> <p>1 Familje e përbërë me 1 deri 2 persona sipas çertifikatës familjare.</p> <p>2 Familje e përbërë me 3 dhe më shumë persona sipas çertifikatës familjare.</p> | <p>2,900 lekë/vitë</p> <p>4,100 lekë/vitë</p> |
| <p>Njësia Administrative Ruzhdiç:</p> <p>Fshati Ruzhdiç</p> <p>Fshati Gjinoqarë</p> <p>Fshatrat Drenie, Kasnicë dhe Siqecë</p> | <p>700 lekë/vitë</p> <p>700 lekë/vitë</p> <p>0 lekë /vitë</p> |

e) Tarifa për shërbimit komunitar

| Kategoritë | Niveli i tarifës së Shërbimit Komunitar. |
|-----------------------------------|--|
| Njësia Administrative Patos | 700 lekë/vitë |
| Njësia Administrative Zharëz | 700 lekë/vitë |
| Njësia Administrative Ruzhdië: | |
| Fshati Ruzhdië | 300 lekë/vitë |
| Fshati Gjinoqarë | 300 lekë/vitë |
| Fshati Drenie, Kasnicë dhe Siqecë | 0 lekë/vitë |

2.3 Përjashtimet dhe lehtësirat

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- ❖ Pronat e shtetit dhe të Njësive të Qeverisjes Vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- ❖ Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ❖ Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ❖ Banesat sociale në pronësi të Bashkive;
- ❖ Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ❖ Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ❖ Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ❖ Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë.
- ❖ Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ❖ Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Lehtësirat për tokën bujqësore:

1. Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutorë dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
2. Taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.
3. Personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;
4. Për taksapaguesit të cilët do të paguajnë taksën e tokës bujqësore brenda muajt Gusht do të ulët taksa në masën 20 për qind vetëm për Njësinë Administrative Zharrëz.
5. Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, vetëm për normën individuale të tokës, individët:
 - Invalidët e punës e të luftës, veteranët
 - Të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Për të përfutuar nga përjashtimi, këto familje apo individ duhet të dorëzojnë në zyrën e taksave pranë Bashkisë ose të Njësisë Administrative dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Proçesverbalin e mbajtur nga komisioni i verifikimit për mbjelljet e reja.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Lehtësira dhe përjashtime për tarifën:

- Familjet e veteranëve niveli i tarifës do të jetë 0 lekë (theksojmë nuk përfitojnë pasardhës veteranësh)
- Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifës do të jetë 0 lekë .
- Familjet e të përndjekurve politik niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.

2.4 Afatet e pagesës

Afati për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë *individ familjar* është data **30 Dhjetor** i vitit kalendarik.

Afati për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë *biznes* është data **30 Qershor** i vitit kalendarik.

2.5 Gjobat dhe kamatvonesat

Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Tatimpaguesi biznes i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer.

Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.